

The Highland Lute
Kur vargjet e Fishtës flasin edhe anglisht

Gjendet në Tiranë për të promovuar “The Highland Lute,” veprën epiko-lirike të Gjergj Fishtës, e cila kësaj here ka nisur të flasë anglisht.

Shkrimtar, albanolog, përkthyes, interpret: ky është Robert Elsie, i cili së bashku me Janice Mathie-Heck kanë ndërmarrë prej disa vitesh të përkthejnë në gjuhën angleze 15612 vargjet e “Lahutës së Malcis” se Fishtës. Me një shqipe të shkëlqyer që ndihet edhe në komunikimin e thjeshtë, Elsie ka hasur jo pak vështirësi në përkthimin dhe përshtatjen e gegërishtes së Fishtës. E megjithatë, shprehet i bindur “nese kam arritur të përkthej veprën e Fishtës, jam gati të përkthej gjithçka nga shqipja.”

[A.H.]: Dr. Elsie, kur jeni njohur për herë të parë me “Lahutën e Malcis”?

[R.E.]: Kisha dëgjuar për “Lahutën e Malcis”, por nuk e kisha parë për një kohë të gjatë, sepse në periudhën e komunizmit ajo ishte e ndaluar. Nuk flisnin fare për Fishtën. Ishte një heshtje e plotë, por kishte një botim të Lahutës në Romë, nëse nuk gabohem në vitin 1958. Një libër që nuk gjendej fare në Shqipëri, por që u shpërnda në botën e jashtme, në emigracion, dhe aty e pashë për herë të parë në origjinal. Përveç kësaj, kam parë një përkthim në Gjermani të vitit 1958. Kështu që vepra ishte e njohur, por nuk dija për rëndësinë e këtij libri. Zgjati shumë sa të mësoja pak për Fishtën, por mbase është kjo që molla e ndaluar të tërheqë më tepër, dhe Fishta ishte i tillë.

[A.H.]: Kur keni nisur ta përktheni “Lahutën e Malcis”?

[R.E.]: Fillova në vitin 2001 dhe përkthimi zgjati më shumë se 3 vjet. Ishte përkthim i vështirë, për mua ishte i tillë, prandaj zgjati kaq shumë. Ka gjëra pafund, po mendoj se çdo njeri do gjejë te Fishta atë që do. Është një vepër letrare me cilësi të lartë. Ka histori, ka mitologji, ka frymë. Më frymëzoi shumë, megjithëse ka dhe pjesë që më mërznin shumë. Ka beteja pafund me gjak, me jataganë, me pushkë, që nuk ishin për mua, por që të tjerët mbase i pëlqejnë. Siç duket, at Fishta kishte qejf për gjak.

[A.H.]: Si ju është dukur gjuha e Fishtës?

[R.E.]: Kjo është një bisedë pafund. Është një gjuhë shumë e përpunuar, por mjaft e vështirë për mua, sepse kisha mësuar gjuhën letrare, dhe gegërishtja e Fishtës nuk ishte punë e lehtë për mua. Por me kalimin e kohës u bëra pak malësor edhe vetë. Më të lehtë e kam ende nga toskërishtja, me gjithë përvojën që kam tani me Fishtën. Më duket se Fishta është vepra më e vështirë për t’u përkthyer nga të gjitha. Dhe besoj se nëse arrij të përkthej Fishtën, arrij të përkthej gjithë veprat e tjera, por gjuha standarde është më e lehtë për mua.

[A.H.]: A është vlerësuar “Lahuta e Malcis” të paktën nga sfera të caktuara?

[R.E.]: Është akoma herët për të folur. Libri ka gjashtë muaj që ka dalë në treg. Iu shpërnda fillimisht ekspertëve dhe nuk kam pasur kontakt me shtëpinë botuese, që të di se sa ishte

tirazhi, se sa u shit, se kush e bleu. Në përgjithësi letërsia shqiptare ka shumë vështirësi, sepse është e panjohur përveç Ismail Kadaresë, që është pjesërisht i njohur. Për Gjergj Fishtën, një autor krejtësisht i panjohur është shumë e vështirë, por mendoj se me kalimin e kohës, me ngadalë libri do të eci. Nuk pres që të gjithë të blejnë “Lahutën e Malcisë” dhe që libri të futet në listën e best-sellerave.

[A.H.]: Sa autorë shqiptarë keni përkthyer dhe cili është i preferuari juaj?

[R.E.]: Kam përkthyer shumë, nuk di të them tani, por i pëlqej të gjithë, ndryshe nuk i përktheja. Ata që përkthej zakonisht i pëlqej. Natyrisht ka shumë autorë të mirë, por ka dhe të dobët. Ky është problem që duhet të zgjidhet. Kush ka vlerë dhe kush jo.

[A.H.]: Si e shpjegoni që letërsia shqipe në përgjithësi është shumë pak e përkthyer në botë?

[R.E.]: Nuk mund të ketë përkthime në treg, nëse nuk ka përkthyes. Kjo është pengesa kryesore. Ka një mungesë përkthyesish. Po të kishte përkthyes shumë, me siguri do të kishte shumë botime. Megjithatë, prap dua të them se në tregun anglishtfolës, të cilin unë e njoh më mirë është shumë e vështirë për të hyrë. Në tregun e librave të letërsisë, në Angli të paktën, më pak se 2 përqind janë përkthime nga gjuhë të huaja. Domethënë, 98 përqind e botimeve janë të shkruara në anglisht dhe ka shumë pak vende, dhe në këto 2 përqind vijnë gjithë letërsitë e botës. Kështu që, imagjinoni sa përqind mund të ketë nga kjo, letërsia shqiptare. Por pengesa kryesore është mungesa e përkthyesve. Pastaj, gjuha shqipe nuk është një gjuhë e lehtë për t'u mësuar, por edhe izolimi i Shqipërisë. Shqipëria ka qenë e izoluar për 50 vjet. Asnjëri nuk hynte, asnjëri nuk dilte. Nuk kishte kontakte, përveç disa kontakteve politike të karakterit komunist. Por normalisht, asnjëri nuk mund të hynte. Ky ishte problemi im kur doja të mesoja shqip. Nuk kisha si të flisja me njerëzit, bile as nuk kisha mundësi të vija në Shqipëri. Ishtë shumë e vështirë, vetëm me grupe që ruheshin, vëzhgoheshin. Atë pak shqip që dija, në fillim nuk mund ta praktikojta këtu.

[A.H.]: Ju kur e keni vizituar për herë të parë Shqipërinë?

[R.E.]: Isha për herë të parë në vitin 1978. Pata fat, isha student në Gjermani dhe pedagogu im kishte lidhje me Akademinë e Shkencave në Shqipëri dhe për habinë tonë morëm një ftesë, jo vetëm për profesorin por edhe për të gjithë grupin dhe erdhëm një grup studentësh, afërsisht 20 studentë. Për ne ishte gjë e madhe.

[A.H.]: Pas kësaj vepre, cilat janë planet tuaja më të afërta në fushën e përkthimit?

[R.E.]: Do të botoj së shpejti një antologji të prozës shqiptare, pra të tregimit shqiptar. Libri do të dalë në SHBA në qershor ose korrik. Përveç kësaj, po punoj për një antologji të poezisë shqiptare dhe disa vepra të tjera herë pas here.

intervistoi Arjola Herkurani

[botuar në: *Republika*, Tiranë, 29 prill 2006, f. 16 / Published in: *Republika*, Tirana, 29 April 2006, p. 16.]